



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 14/ 5 prot

Datë 02/02/2024

V E N D I M
Nr. 130/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/02/2024 me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me numë reference: REF-92432-12-28-2023, me objekt: “*Blerje program fiskalizimi*”, me fond limit 5.166.667 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Nexia AL Consulting*” SHPK me NIPT: L82210031Q me adresë: *Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati “Viridario 1”, Kati 2, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A
Adresa: Lagjja “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa”, Elbasan.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.12.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numë reference: REF-92432-12-28-2023, me objekt: “Blerje program fiskalizimi”, me fond limit 5.166.667 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

II.2. Në datën 04.01.2024 operatori ekonomik “Nexia AL Consulting” SHPK ka dorëzuar ankesën njëkohësisht si pranë Komisionit të Prokurimit Publik ashtu edhe pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konsatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës me numër nr. 03/1 prot., datë 08.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 14/2 prot., datë 11.01.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK dhe ka njoftuar atë dhe Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur mos pranimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e parë të ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit dhe konkretisht për sa i përket kërkesës për përcaktimin e emrit të bankës në të cilën ndodhet llogaria e entit prokurues, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.1.b të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;”.

III.1.2. Në shtojcën 3 “FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS” autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes së sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Shtojca 3.

*[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik]
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS*

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Ndërsa në Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike, Pikat 3.1.2 dhe 3.1.3 të po këtyre dokumenteve të tenderit objekt-ankimimi përcaktohet mënyra e pagimit të sigurimit të ofertës si më poshtë:

3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor AL3820531050026650CLPBCLALLM (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **x**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **x**

III.1.3. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor.

Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.

III.1.4. Në nenin 30 pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.”.

III.1.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 03/1 prot, datë 08.01.2024 drejtuar ankimuesit e ka trajtuar këtë pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si në vijim: “Duke ju referuar pikës 1 të ankesës, sjellim në vëmendje të operatorit ankimues që shtojca për sigurimin e ofertë është plotësuar nga ana e AK konform udhëzimeve të përcaktuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Më konkretisht në datën 10.05.2022 APP ka miratuar Dokumentet Standarte të Tenderit për të gjitha llojet e procedurave dhe më konkretisht dhe për procedurën “E hapur, e thjeshtuar, shërbime”, në të cilën është klasifikuar dhe procedura objekt ankimi. Në këtë DST “Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” është përcaktuar dhe pika 3.1 “Sigurimi i ofertës” dhe ndërmjet të tjerave këtu është përcaktuar dhe mënyra se si do plotësohet kjo shtojcë nga ana e Autoriteti Kontraktor. Më konkretisht po të shikojmë në Pikën 3.1.2 në kllapa është shënuar mënyra se si duhet të plotësohet hapësira boshe nga AK ku specifikohet “të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor” dhe në mbështetje të kësaj Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Elbasan sha, ka vendosur Iban të llogarisë së saj. Ne vijim theksojmë që gjithashtu në Pikën 3.1.3 është përcaktuar forma sipas të cilës operatorët ekonomikë të interesuar, mund të paraqesin sigurimin e ofertës dhe janë zgjedhur të dyja opsionet që parashikon ligji për sigurimin e ofertës. Theksojmë që Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Elbasan sha, ka plotësuar këtë shtojcë konform të gjitha rekomandimeve dhe udhëzimeve të APP dhe gjithashtu konform të gjithë bazës ligjore.

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën lidhur me këtë kriter vendosi se pretendimi juaj nuk qëndron.”.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të ligjore të sipërpërmendura meqenëse vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ka parashikuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit sigurimin e ofertës në vlerën 2% të fondit limit sipas Shtojcës 3 të dokumenteve të tenderit, por nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve dhe konkretisht pikës 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar 2 (dy) alternativa dhe konkretisht paraqitjen e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare ose nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së. KPP në interpretim të normës ligjore të sipërcituar në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” lidhur me mënyrën e paraqitjes së sigurimit të ofertës nga ana e ofertuesve konstaton se ligjvënësi ka parashikuar dy forma të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është ajo në formën e garancisë bankare dhe tjetra është ajo nga një shoqëri e licencuar, por që në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor në procesin e hartimit të dokumenteve të tenderit janë përcaktuar këto dy forma të paraqitjes së sigurimit të ofertës, por në rastin e paraqitjes së sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare është dhënë në dokumentat e tenderit vetëm numri i llogarisë bankare të autoritetit kontraktor, ndërkohë nuk është dhënë emri i bankës në të cilën mund të operojnë me këtë numër llogarie operatorët ekonomik ofertues, me qëllim paraqitjen e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare, pasi në Republikën e Shqipërisë operojnë disa banka të nivelit të dytë dhe për ofertuesit është humbje kohe identifikimi i bankës në të cilën mund të operojnë me këtë numër llogarie. Nisur nga sa më sipër, KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit qëndron ndaj, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë pikën 3.1.2 të dokumentave të tenderit duke përcaktuar edhe emrin e bankës në të cilën ndodhet numri i llogarisë bankare të publikuar prej tij, me qëllim që ti japi mundësinë operatorëve ekonomik ofertues që dëshirojnë të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e garancisë bankare.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e dytë dhe të tretë të operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK ku kërkon: “Mqs si në shtojcën 5 ashtu edhe më sipër nuk është e qartë periudha kohore në të cilën do të kryhen disa shërbime/furnizime produkti, a mundet të sqaroni dhe plotësoni me të dhëna se:

Kush shërbim/mall do të duhet të realizohet për një periudhë 12 mujore?

Kush shërbim/mall do të duhet të realizohet për një periudhë 3 ditore?

A do duhet që të paktën shërbimet/mallrat e dy pyetjeve të mësipërme të jenë zëra të veçantë në listën e shërbimeve me qëllim jo vetëm të evidentimit të tyre të saktë gjatë procesit të realizimit, por edhe të preventivimit të tyre dhe likuidimeve pjesore sipas kostove dhe afateve të realizimit të siccilit prej tyre? Duke e konsideruar si të paplotë dhe në kundërshtim me ligjin, kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin me të dhënat e plota të domosdoshme.

A e ka përlogaritur saktë autoriteti kontraktor vlerën e të paktën këtyre dy zërave që prokuron (duke mos u ndalur në shërbimet e tjera që kërkohen në detyrat e operatorit ekonomik si:

i) integrimin e programit të fiskalizimit me atë të faturimit;
ii) suportin e stafit në zëvendësimin e certifikatës elektronike; etj.) në përcaktimin e DST
Procedurë e Hapur e Thjeshtuar — Shërbime me objekt Blerje program fiskalizimi?
Vetë togfjalëshi “Blerje program fiskalizimi” në objektin e prokurimit nënkupton kryesisht një
mall, një produkt të gatshëm.
Nga përvojat e derisotme (tonat dhe të operatorëve të tjerë në procedura të ngjashme) dhe
duke supozuar se zërat kryesore të kontratës janë: i) instalimi i programit të fiskalizimit; ii)
integrimi me programin e faturimit dhe iii) mirëmbajtja për një periudhë 12 mujore,
vlerësojmë që një vlerë e konsiderueshme e kësaj kontrate është ajo e furnizimit të mallit pasi
fondi limit për këtë procedurë prokurimi është disa herë më i lartë se ai i procedurave të
ngjashme që nuk kanë furnizim malli si pjesë përbërëse të tyre. Rrjedhimisht vlerësojmë se
objekti kryesor është furnizimi mallrash.
Duke ju referuar dhe kërkesës tonë më sipër (II) kërkojmë ndërhyrjen e autoritetit kontraktor
për sqarimin dhe plotësimin e llojit të kontratës që prokuron.” Komisioni i Prokurimit Publik
vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumenteve të
tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar specifikimet teknike të shërbimeve që
do të objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: “Program Fiskalizimi në Cloud i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing
për një periudhë 12 mujore”.

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj.:

Hyrje

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan përfshin 6 (gjashtë) bashki me një shtrirje
gjeografike të konsiderueshme dhe gjeneron rreth 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) fatura
për abonentët e saj. Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të
Qarkullimit” dhe Udhëzimit nr. 16 datë 03. 04. 2020 “Për faturën dhe Sistemin e
Monitorimit të Qarkullimit” dhe Vendimit Nr. 239 datë 20. 03. 2020 “Për Kërkesat teknike
dhe funksionale të zgjidhjes softëare për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe
procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve softëare-
ike”, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan kërkon zbatimin e një programi
fiskalizimi me integrim me programin e Faturimit – Arkëtimit ekzistues Flare Billing, që ka në
përdorim, për të fiskalizuar faturat e abonentëve si dhe gjenerimin e faturave për shërbimet e
tjera që ajo kryen.

Zbatimi

SHRUK Elbasan kërkon që të gjithë funksionalitetet e programit të fiskalizimit që ofron
zgjidhja, të jenë funksionale dhe të përdorshëm për SHRUK Elbasan. Zbatimi i këtij
programi duhet të marrë parasysh aspekte si fiskalizimi i mbi 67 000 faturave në të njëjtën
kohë, përdorimin nga shumë përdorues në të njëjtën kohë. Mos kufizimi në sasinë e faturave

që mund të fiskalizohen në total. Të mos ketë kufizime në numrin e përdoruesve që do ta përdorin sistemin. Çdo përparësi tjetër që operatori ekonomik mendon se ka programi që ofrohet prej tij, t'i bëhet e ditur SHRUK Elbasan sha, në lidhjen e kontratës dhe të të zbatohet në rast se AK e vlerëson të argumentuar dhe të dobishëm për përdorim. Çdo konfigurim që ofrohet në program, të kryhet sipas specifikave që ka natyra e biznesit të SHRUK Elbasan sha, dhe jo konfigurime të gabuara apo të përgjithshme, të pa dobishme për AK.

Integrimi dhe komunikimi

Sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtimit është i bazuar mbi një zgjidhje të gatshme informatike "Flare Billing". Kodi burim për kryerjen dhe zbatimin e shërbimit, ndodhet në serverin e zyrave të SHRUK Elbasan sha. Faturat e gjeneruara nga ky sistem duhet të fiskalizohen sipas udhëzimeve ligjore. Sistemi i fiskalizimit duhet të integrohet me sistemin ekzistues të Faturim – Arkëtimit, për të bërë të mundur që procesi i fiskalizimit të faturave dhe të gjitha veprimet e brendshme që duhet të kryhen në sistemin e Faturim - Arkëtimit të realizohen me sukses për të siguruar mbarëvajtjen e punës.

Programi i fiskalizimit duhet të përdorë ëb shërbime për të komunikuar me sistemin e Faturim - Arkëtimit që përdorin protokollin standard të komunikimit siç janë SOAP, REST ose ekuivalentet e tyre. Performanca e programit të fiskalizimit nuk duhet të përkeqësojë performancën e sistemit të Faturim - Arkëtimit.

Siguria

Integrimi i zgjidhjes së fiskalizimit me atë të Faturim – Arkëtimit, duhet të kryhet në mënyrë të sigurt. Meqenëse programi i fiskalizimit kërkohet të ofrohet në Cloud, komunikimi me sistemin e faturimit duhet të plotësojë të gjithë kriteret e sigurisë dhe të shifrimit për të minimizuar risqet dhe për t'u mbrojtur nga sulme dashakeqe që mund t'i shkaktojnë dëme SHRUK Elbasan sha dhe abonentëve të shoqërisë sonë.

Në përgjithësi programi i fiskalizimit që do të zbatohet në Cloud, duhet të përmbushë të gjitha standardet e mirëfunksionimit të sigurt në Cloud siç janë aksesimi i sigurt, siguria e mjediseve të instalimit, siguria e bazës së të dhënave, mundësia e backup dhe restore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Për Sigurinë Kibernetike", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15. 07. 2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", i ndryshuar, AK është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe e rëndësishme të informacionit, si rrjedhim sistemi dhe infrastruktura mbështetëse e ofruar duhet të auditohen dhe të ofrohet përditësim i vazhdueshëm nga ana e sigurisë kibernetike.

Baza e të dhënave

Baza e të dhënave duhet të jetë e optimizuar që të përballojë sasinë prej të paktën 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) faturave aktuale që do të fiskalizohen në të njëjtën kohë çdo muaj, rritjen e vazhdueshme të numrit të faturave dhe veprimeve që do të kryejnë përdoruesit në sistem, gjenerimin e raporteve kurdo që t'i duhet përdoruesve të SHRUK Elbasan. Baza e të dhënave duhet të jetë e pa aksesueshme nga përdorues të tjerë, përveç specialistëve të operatorit ekonomik për nevoja të mirëmbajtjes. Të dhënat në bazën e të dhënave nuk duhet të modifikohen në ndërhyrje të drejtpërdrejt në bazën e të dhënave, duke anashkaluar ndërfaqen e programit. Gjatë zbatimit të kontratës, vetëm nëse SHRUK Elbasan do ta kërkojë, operatori ekonomik nëpërmjet procedurave të mirë-përcaktuara, duhet të bëj

ndërhyrje në bazën e të dhënave. Operatori ekonomik në mënyrë të vazhdueshme duhet të kujdeset që baza e të dhënave të jetë e optimizuar për të dhënë performancë maksimale.

Menaxhimi i projektit

Operatori ekonomik duhet të ndjekë procese pune të mirë-planifikuara gjatë zbatimit të kontratës, sipas udhëzimeve të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve. Në mendimin tonë, metodologjia agile ose ekuivalente e saj, do të ishte më efikase e cila ndihmon në lëvrimin e projekteve në një shtrirje kohore të shkurtër dhe ofron feedback për të gjithë palët e përfshirë në projekt duke mundësuar të ndërhyhet në kohë nëse ndonjë prej proceseve nuk jep rezultatin e pritur. Menaxheri i projektit të operatorit ekonomik do të ketë në dispozicion specialistët e SHRUK Elbasan që ata të japin informacionin e duhur. Menaxheri i projektit duhet t'i bëjë të ditur planin e saktë të punës specialistëve të SHRUK Elbasan duke i qartësuar momentet kur ata do të jenë të domosdoshëm dhe çfarë kontributi pritet prej tyre që në nisjen e zbatimit të kontratës dhe gjatë të gjithë fazave të zbatimit të saj deri në dorëzim të plotë të kontratës.

Menaxhimi i shërbimit

Pasi programi të ketë nisur zbatimin dhe të ketë filluar përdorimi nga personat përkatës të SHRUK Elbasan sha, për të gjithë afatin që mbetet deri në përfundim të kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë të gjithë burimet e nevojshme për ruajtjen e nivelit të shërbimit të pandërprerë. Gjatë periudhës që ofrohet shërbimi, duhet të ketë një komunikim të rrjedhshëm mes personave përgjegjës nga ana e SHRUK Elbasan dhe menaxherit të shërbimit të operatorit ekonomik. Meqenëse shërbimi do të ofrohet në Cloud, është domosdoshmëri për SHRUK Elbasan sha, të ketë aktivitet ekonomik të pandërprerë. Mungesa e shërbimit si p.sh. mos fiskalizimi i faturave ose mos fiskalizimi në kohën e planifikuar, ndikon drejt për drejt në mungesën e të ardhurave për SHRUK Elbasan sha. Operatori Ekonomik duhet të menaxhojë mbarëvajtjen e ofrimit të shërbimit sipas praktikave ndërkombëtare të mirënjohura të ITIL ose ekuivalente.

Funksionalitetet që duhet të ketë programi:

Funksionet për Klientin:

- Programi të mundësojë marrjen dhe regjistrimin automatikisht të të gjithë klientëve nga sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtim.
- Programi të mundësojë regjistrimin e klientëve manualisht.
- Programi të regjistrojë klientë me ID jo shqiptare.
- Programi të regjistrojë automatikisht Emër Mbiemër, Adresë kur në program vendoset NIPT-i i klientit.
- Programi të mundësojë kërkimin e një klienti:
 - me anë të **numrit të kontratës**,
 - me anë të **NIPT-it**,
 - me anë të **ID** të klientit ose me **Emër Mbiemër**.
- Programi të mundësojë eksportin e të gjithë klientëve në format Excel.

Funksionet për Artikullin:

- Programi të mundësojë marrjen dhe regjistrimin automatikisht të gjithë artikujve nga sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtim.

- Programi të mundësojë regjistrimin e artikujve manualisht.
- Programi të mundësojë vendosjen e niveleve të çmimeve.
- Programi të mundësojë editimin e artikullit si në zë ashtu dhe në çmim.
- Programi të mundësojë vendosjen e një kodi unik.
- Programi të mundësojë kërkimin e një artikulli me anë të kodit ose emërtimit.
- Programi të mundësojë eksportin e të gjithë Artikujve në format Excel.
- Programi të mundësojë importin me anë të file Excel.

Funksionet për Faturat:

- Programi të mundësojë krijimin e Faturës me para në dorë.
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës pa para në dorë (e thjeshtë).
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës Elektronike.
- Programi të mundësojë krijimin e Vetëfaturimit.
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës Shoqëruese.
- Programi të mundësojë korrigjimin e Faturës.
- Programi të ruajë çdo version të Faturave.
- Programi të ketë mundësi të filtrojë fatura në bazë të emrit të klientit, datës, dhe totalit të faturës.
- Programi të ketë mundësi të eksportoje të gjithë faturat në file Excel.
- Programi të ketë mundësi të opsionit të pranimit të faturave që vijnë nga të tretë direkt nga ndërfaqja.

Funksionet për Arkat:

- Programi të ketë mundësi krijimin automatik të Mandatit të Arkëtimit për Faturat me para në dorë që bëhen në mënyrë manuale.
- Programi të ketë mundësi krijimin e Mandatit të Pagesës.
- Programi të ketë mundësi të gjenerojë raporte për periudha të ndryshme për gjendjen e Arkës.

Konfigurimet:

- Programi duhet të ketë rubrika për të gjitha konfigurimet e tij.
- Programi të ketë mundësi të krijimit të Roleve nga ana e vetë përdoruesit të SHRUK Elbasan.
- Programi të ofrojë mundësinë e konfigurimit të të drejtave të detajuara dhe të kombinuara, të paktën sipas mundësive të të drejtave si vijon:

Të drejta rreth klientëve	Shfaq Listën e Klientëve
	Krijo Klient të ri
	Modifiko Klient ekzistues
	Fshij Klient ekzistues
	Ruajtje me aprovim
	Administro Listën e Nivelit të Cmimeve
	Administro Nivelin Bazë të Cmimeve
	Cmimeve

Të drejtat për Vendet e Ushtrimit të	Krijo Vendet ku Ushtrohet Aktiviteti
	Edito Vendet e Ushtrimit të Aktivitetit
	Lista e Vendeve e Ushtrimit të Aktivitetit

Të drejtat rreth Arkava	<i>Shfaq Listën e Arkave</i>
	<i>Çel Arkë të re</i>
	<i>Modifiko Arke ekzistuese</i>
	<i>Fshij Arkë ekzistuese</i>
	<i>Krijo Mandat Arkëtimi</i>

Të drejtat rreth Faturave	<i>Shfaq Listën e Faturave të shitjes</i>
	<i>Krijo Faturë Shitje të re</i>
	<i>Modifiko Faturë Shitje ekzistuese</i>
	<i>Ruaj Faturë Shitje</i>
	<i>Shfaq Listën e Faturave Elektronike</i>
	<i>Printo e Invoice</i>
<i>Ndrysho statusin e Invoice</i>	

Të drejta rreth artikujve	<i>Shfaq Listën e Artikujve</i>
	<i>Krijo Artikull të ri</i>
	<i>Modifiko Artikull ekzistues</i>
	<i>Fshij Artikull ekzistues</i>
	<i>Ruajtje me aprovim</i>
	<i>Administro Nivel Çmimesh</i>

Të drejtat për Përdoruesit	<i>Krijo të Përdorues i ri</i>
	<i>Aktivizo Përdorues ekzistues</i>
	<i>Modifiko Përdorues ekzistues</i>
	<i>Lista e Përdoruesve</i>
	<i>Ndryshim i Fjalëkalimit të Përdoruesit</i>
	<i>Profili i Përdoruesit</i>

Konfigurime	<i>Cakto të drejta për çdo rol</i>
	<i>Modifiko të drejtat për çdo rol ekzistues</i>
	<i>Fshij rol ekzistues</i>
	<i>Ruaj Rol ekzistues</i>
	<i>Raportet që mund të ketë akses</i>

Të drejtat rreth Raporteve	<i>Shitjet sipas artikujve</i>
	<i>Libri i shitjeve</i>
	<i>Gjendja e Arkës</i>
	<i>Shitjet sipas muajve</i>
	<i>Shitjet sipas datave</i>

Funksione dhe veçori të tjera të programit:

- Të jetë i aftë të fiskalizojë të gjithë faturat e abonentëve (të paktën 67 000 fatura), çdo muaj, brenda një periudhe 2 ditore.
- Të integrohet me sistemin ekzistues të Faturim - Arkëtimimit.
- Vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese.

- Të gjenerojë automatikisht Librin e Shitjeve.
- Dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin tatimor, duke përdorur certifikatën elektronike.
- Transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese.
- Ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese.
- Gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH).
- Gjenerimin e kodit QR.
- Printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
- Bazat e të dhënave të jenë të pa aksesueshme jashtë këtij sistemi.
- Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “Përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
- Të ketë Log Files për çdo rast gjatë transmetimit të të dhënave nga programi drejt sistemit tatimor.
- Programi duhet të ketë auditimin e të dhënave.

Detyrat e operatorit ekonomik

- Të zbatojë programin e fiskalizimit brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
- Të integrojë brenda afatit programin e fiskalizimit me atë të Faturim – Arkëtimit.
- Të mirëmbajë programin e fiskalizimit për periudhën e përcaktuar në kontratë.
- Të suportojë stafin në zëvendësimin e certifikatës elektronike.
- Të garantojë sigurinë e të dhënave meqenëse programi është i instaluar në Cloud.
- Të garantojë back-up të të dhënave në Cloud.
- Të informojë Shoqërinë për çdo ndryshim në program.
- Të zbatojë të gjithë kërkesat e SHRUK Elbasan të përcaktuara në këtë DST.

PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre. Suporti dhe përgjigjet do të kryhen në orarin zyrtar të punës 08:00-16:30 në ditë pune nga e Hëna në të Enjte, dhe 08:00 – 14:00 ditë të Premte, përjashtuar ditët e festave zyrtare.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategoria C (I Ulët)
Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i programit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		

Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë të punës së tyre</u>	Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<u>Nuk ka një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min. për të kthyer përgjigje	○ 30 min. për të kthyer përgjigje
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

III.2.2. Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumenteve të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar sasitë dhe grafiku i shërbimeve objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Objekti: Shërbimet që kërkohen: “Program Fiskalizimi i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing për një periudhë 12 mujore”.

Shërbi met	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Program Fiskalizimi në Cloud i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing për një periudhë 12 mujore	Sipas Specifikimeve teknike	Sipas Specifikimeve teknike

- Afati i kontratës është 12 muaj duke nisur nga data e marrjes në dorëzim të zbatimit total të zgjidhjes. Afati i implementimit bashkë me integrimin me Sistemin Flare Billing, 3 (tri) ditë nga lidhja e kontratës.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, e krijuar më 1 janar 2023, ka në përbërje të saj njësitë: Elbasan, Gramsh, Peqin, Belsh, Librazhd dhe Cërrik.

Në të gjitha këto njësi bëhen pagesat e faturave të ujit të pijshëm, fatura të cilat mbështetur në udhëzimin “PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”, Neni 2 “Fusha e veprimit”, pika “1. Sipas nenit 2 të ligjit, dispozitat e këtij udhëzimi

zbatohen nga të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura në përputhje me Ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe Ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe përcakton detyrimet për lëshimin e faturës dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit në kohë dhe detyrimeve të tjera.", janë pjesë e sistemit të fiskalizimit të tyre.

Numri i arkave të shoqërisë, që përdorin zgjidhjen me fiskalizim, janë si më poshtë:

Njësia Elbasan 1 (një)

Njësia Gramsh 1 (një)

Njësia Peqin 1 (një)

Njësia Belsh 1 (një)

Njësia Librazhd 1 (një)

Njësia Cërrik 1 (një).

Për procedurën e prokurimit për Fiskalizimin e Faturave të shoqërisë, të mbahet parasysh numri i arkave që përdorin këtë sistem, me parashikim edhe për zgjerim në rast të rritjes së numrit të abonentëve.

III.2.2. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues "Nexia AL Consulting" ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 03/1 prot, datë 08.01.2024 drejtuar ankimuesit e ka trajtuar këtë pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si në vijim: "Duke ju referuar pikës 2 të ankesës, ju sjellim në vëmendje specifikimet teknike të parashikuara në DST dhe gjithashtu tabelën e shërbimeve. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, ka parashikuar ndërmjet të tjerave në shtojcën 6 "Formulari i shërbimeve dhe grafiku i ekzekutimeve" tabelën me shërbimet e kërkuara dhe ka saktësuar me anë të një shënimi që: "Afati i kontratës është 12 muaj duke nisur nga data e marrjes në dorëzim të zbatimit total të zgjidhjes. Afati i zbatimit bashkë me integrimin me Sistemin Flare Billing, 3 (tri) ditë nga lidhja e kontratës", pra siç mund të konstatohet mjaft qartë, kemi të bëjmë me një afat 3 ditor që AK i ka lënë OE për të zbatuar dhe integruar programin e fiskalizimit që do të ofertojë me programin e faturimit që Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha. Ky afat është mjaft i qartë dhe nuk ka vend për moskuptim nga operatori ekonomik ankimues. Për sa i përket detyrave të përcaktuara për operatorin ekonomik sipas të cilës OE ankimues ka ngritur pretendime që nuk janë përfshirë në tabelën e çmimeve gjejmë me vend t'ju kujtojmë që këto janë detyra të përgjithshme të cilat duhet të bëhen gjatë zbatimit të kontratës, dhe janë të përfshira brenda objektit që AK ka përcaktuar në tabelën për të cilën do të ofertojnë operatorët ekonomikë të interesuar. Kujtojmë që është në tagrin e AK përcaktimi i specifikimeve sipas nevojave të saj për zbatimin me rigorozitet të kontratës. Rikujtojmë gjithashtu që AK në zbatim të ligjit ka kryer dhe testimin e tregut për shërbimet objekt prokurimi dhe në këto teste tregu, ofertimi është bërë sipas kërkesës së AK dhe në asnjë moment nuk kemi pasur një kundërshti. Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën lidhur me këtë kriter vendosi se pretendimi juaj nuk qëndron.

Duke ju referuar pikës 3 të ankesës, theksojmë që në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me një kontratë të përzier. Operatori ekonomik ankimues në bindjen tonë ka gabuar në mënyrën e leximit të kriterëve dhe kryesisht të specifikimeve teknike të përcaktuara, pasi e gjithë procedura është një shërbim të cilin AK e kërkon sipas nevojave të tij, për mirëfunksionimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për fiskalizimin e faturave. Kërkesa e AK është legjitime për të pasur një program fiskalizimi dhe integrimin e tij me programin e faturimit brenda

afatit 3 ditor të përcaktuar. Si rezultat i nevojës emergjente që AK ka për fiskalizimin e faturave, çka lidhet drejtëpërsëdrejti me arkëtimin dhe financat e AK, ka përcaktuar afatin kohor që duhet operatori ekonomik fitues të zbatojë dhe të integrojë programin e fiskalizimit me programin e faturimit që AK ka në përdorim. Theksojmë dhe në këtë moment që AK ka bërë testimin e tregut sipas përcaktimeve ligjore përkatëse dhe operatorë të ndryshëm ekonomikë kanë treguar interes dhe gatishmëri për realizimin e kësaj detyre brenda afateve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën lidhur me këtë kriter vendosi se pretendimi juaj nuk qëndron.”.

III.2.3. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës

për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret lidhur me pretendimet e ankimuesit të cilat janë në formën e kërkesave për sqarim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se argumentet e dhëna nga autoriteti kontraktor mbështeten vetëm në parashikimet ligjore të legjislacionit për prokurimin publik, por nga ana tjetër nuk i ka dhëne sqarimet e kërkuara nga ana e ankimuesit.

III.2.5. Referuar sa më sipër, KPP gjykon, se për pretendimet të ngritura në formën e sqarimit, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese, specifikimeve teknike, termave të referencës dhe justifikimin për vendosjen e tyre, duhet të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese mbi kërkesat e tij rreth projektit për sa i përket termave të referencës dhe specifikimeve teknike, në mënyrë që të shmangët çdo lloj konfuzioni në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi për lehtësinë e punës së KVO në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Akoma më tej, KPP gjykon, se sqarimi në rastin konkret është i nevojshëm edhe në funksion të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ngarkimit të tyre me të njëjtat të drejta dhe detyrime, duke shmangur kështu trajtimin diskriminues ndërmjet tyre, në kushtet kur mund të ndodhë që operatorë të ndryshëm të mund t'i kuptojnë në mënyra të ndryshme termat e referencës dhe specifikimet teknike të projektit objekt-prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në sqarimin që do t'i japë ankimuesit, duhet të japë përgjigje për secilën kërkesë të parashtruar nga ana e tij, duke e mbështetur në specifikimet teknike dhe sasinë e grafikun e shërbimit objekt-prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 5 dhe Shtojcën 6 të dokumentave të tenderit të publikuar në sistemin elektronik të prokurimit, si dhe njëherazi të bëjë publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e katërt të operatorit ekonomik “Nexia AL Consulting” ShPK ku kërkon: *“Përsa më sipër, duke e vlerësuar të pargumentuar dhe si jo në përputhje e në përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi, ne kërkojmë **heqjen e kërkesës për menaxher projekt** dhe rrjedhimisht **uljen e numrit të punonjesve të diplomuar ne IT**.*

Është kërkuar që punonjësi i certifikuar të jetë në “nivel ekspert në Zbatimin e zgjidhjes së ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidha”. Përcaktimi “nivel eksperti” është i paqartë, krijon konfuzion dhe mund të jetë subjektiv në procesin e vlerësimit. Ky lloj përcaktimi cilësimi nuk mund të provohet me asnjë lloj dokumenti, gjë që vërtetohet nga vetë mungesa e citimit të këtij dokumenti në këtë kriter.

*Përsa më sipër, duke e vlerësuar të paplotë dhe të paqartë, kërkojmë heqjen e togfjalëshit “**nivel eksperti**” të vendosur në këtë kriter.*

*Është kërkuar që punonjësi i certifikuar të jetë në “**nivel eksperti për sigurinë në Cloud**”. Përcaktimi “nivel eksperti” është i paqartë, krijon konfuzion dhe mund të jetë subjektiv në procesin e vlerësimit. Ky lloj përcaktimi cilësimi nuk mund të provohet me asnjë lloj dokumenti, gjë që vërtetohet nga vetë mungesa e citimit të këtij dokumenti në këtë kriter.*

Përsa më sipër, duke e vlerësuar të paplotë dhe të paqartë, kërkojmë **heqjen e togfjalëshit “nivël ekspert”** të vendosur në këtë kriter.

Është kërkuar që punonjësi të jetë i çertifikuar në **“nivël profesionist në implementimin e ëeb shërbimeve nëpërmjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent”**. Përcaktimi “nivël profesionist” është i paqartë, krijon konfuzion dhe mund të jetë subjektiv në procesin e vlerësimit. Ky lloj përcaktimi cilësimi nuk mund të provohet me asnjë lloj dokumenti, gjë që vërtetohet nga vetë mungesa e citimit të këtij dokumenti në këtë kriter.

Përsa më sipër, duke e vlerësuar të paplotë dhe të paqartë, kërkojmë **heqjen e togfjalëshit “nivël profesionist”** të vendosur në këtë kriter.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr. 7 “Formular i Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” në paragrafin 2.3.3 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën **5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT** (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj.). Plotësimi i këtij kriteri duhet të vërtetohet me paraqitjen e formularëve E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave dhe diplomave të shkollimit të lartë universitar për secilin prej punonjësve. Këta punonjës duhet të jenë të certifikuar si vijon dhe një punonjës mund të ketë me shumë se një certifikim:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën **1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti** në nivel profesionist.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

b. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën **1 (një) punonjës të certifikuar në nivel ekspert** në zbatimin e zgjidhjes së ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

c. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën **1 (një) punonjës në nivel ekspert** për sigurinë në Cloud.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

d. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën **1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)**.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

e. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën **1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesionist** në implementimin e ëeb shërbimeve nëpërmjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave në teknologjinë e përdorur në zgjidhjen e ofruar.

- Ky kriter të plotësohet me paraqitjen e certifikatës përkatëse për punonjësit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”.

III.3.2. Në procesverbalin e “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e kriterit kualifikues të sipërpërmendur, si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Për përmbushjen me sukses të kontratës, **numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, përkundrejt natyrës së punës objekt i këtij prokurimi.** Periudha e punësimit jo më pak se tre muaj nga data e publikimit të kësaj kontrate, është tregues për aftësinë profesionale të punonjësve, pasi e kanë kaluar periudhën e provës në marrëdhënie me punëdhënësin. Kjo kërkesë garanton AK për seriozitetin dhe fuqinë punëtore të OE, e domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate. Kjo kërkesë është bazuar në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 1: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

Kriteri për 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatikë ekonomike, shkenca kompjuterike etj.), është në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi përfshin zbatimin, integrimin, menaxhimin dhe sigurinë e të gjitha informacioneve teknike të sistemit dhe të të dhënave.

Si rrjedhim:

a. Punonjës të certifikuar si menaxher projekti në nivel profesionisti garanton ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekt zbatimi që prej analizës dhe dizajnit të kërkesave, parametrave dhe konfigurimeve të sistemit, testimi dhe dokumentimi të projektit. Menaxheri i projektit, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që çdo pikë e tyre të kryhet me sukses dhe cilësi brenda afateve të përcaktuara të kësaj kontrate. Rëndësia që menaxheri i projektit duhet të jetë gjithashtu i diplomuar në fushën e IT lidhet me objektin e procedurës së prokurimit, siç është teknologjia e informacionit.

DETYRAT; Garantoni ndjekjen e të gjithë ciklit të një zbatimit të projektit, e cila përfshin analizim dhe dizajnim të kërkesave, parametrave dhe konfigurimeve të sistemit, testimi dhe dokumentimi të projektit

b. Kriteri për punonjës të certifikuar në nivel ekspert për zbatimin e zgjidhjes së ofruar ose teknologjisë nga e cila përbëhet zgjidhja, vjen si nevojë për aftësinë profesionale në zbatim të zgjidhjes për fiskalizimin, zgjidhjen e problemeve cilat do qofshin ato, dhe të garantojë zbatimin e të gjitha specifikimeve të kërkuara nga AK. Ky specialist garanton funksionimin e të gjitha parametrave dhe sistemit të programit të përcaktuar në Specifikimet Teknike në paragrafin **Zbatimi.**

c. Kriteri për punonjës të certifikuar si ekspert për sigurinë Cloud, është i nevojshëm pasi programi i fiskalizimit bashkë me faturat që do të fiskalizohen, do të jenë të depozituara në Cloud. Për këtë arsye AK duhet të jetë i garantuar që OE në stafin e tij ka punonjës të specializuar në garantimin e ruajtjes së të dhënave, edhe si domosdoshmëri për mbrojtje nga rreziqe të mundshme nga agjentë të jashtëm keqbërës.

Në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Për Sigurinë Kibernetike", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15.07.2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", i ndryshuar, AK është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si rrjedhim sistemi dhe infrastrukturat mbështetëse të ofruara duhet të auditohen dhe të ofrohet përditësim i vazhdueshëm nga ana e sigurisë kibernetike, siç është dhe në specifikimet teknike në paragrafin **Siguria**.

d. Kriteri për punonjës të certifikuar në nivel profesionist në përdorimin dhe zbatimin e Eëb shërbimeve me anë të protokollit SOAP, Rest ose ekuivalente, vjen për të garantuar integrimin mes sistemeve të brendshme me programin e fiskalizimit, integrim ky që përdor protokolle standarde Soap, Rest ose ekuivalente siç është cituar dhe në specifikimet teknike në paragrafin **Integrimi dhe Komunikimi.**

e. Kriteri për punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve ITIL, vjen si rezultatet i nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Meqenëse shërbimi do të ofrohet në Cloud, është kritik për Shoqërinë Rajonale Ujësjetëlës Kanalizime Elbasan sha, për të pasur aktivitet ekonomik të pa ndërprerë. Mungesa e shërbimit në rast të mos fiskalizimit, apo mos fiskalizimi në kohën e duhur, ndikon direkt në mungesën e të ardhurave për AK. OE duhet të menaxhojë mbarëvajtjen e ofrimit të shërbimit sipas praktikave ndërkombëtare të

mirënjohura të ITIL ose ekuivalente siç është përmendur edhe në specifikimet teknike në paragrafin **Manaxhimi i shërbimit**.

f. Kriteri për punonjës të certifikuar si specialist për menaxhimin e bazës së të dhënave në teknologjinë e zgjidhjes së ofruar, vjen si nevojë për të garantuar mirëmbajtjen, optimizimin, shmangien e ndërhyrjes ose manipulimit të databazës, si dhe për të garantuar performancë maksimale ashtu siç dhe është caktuar në specifikimet teknike në paragrafin **Baza e të dhënave**.

Fushat e mësipërme të ekspertizës si dhe numri i personelit të diplomuar në këtë fushë janë kryer në bazë të komponentëve të objektit të kësaj kontrate, si dhe të masës së angazhimit të specialistëve të nevojshëm për të qenë në mbështetje të AK në periudhën e përfundimit të procesit të fiskalizimit që duhet të mundësohet brenda një afati jo më të gjatë se 2 (dy) ditor. Pra procesi i fiskalizimit të faturave në mënyrë që t'u përgjigjet në kohë kërkesave të klientëve të AK, për shlyerjen e detyrimeve që vijnë si proces i faturimit, duhet të kryhet në një kohë jo më të gjatë se dy ditë në mënyrë që AK t'u përgjigjet me profesionalizëm klientëve të saj.

III.3.3. Në shtojcën 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumenteve të tenderit

nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar specifikimet teknike të shërbimeve që do të objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: “Program Fiskalizimi në Cloud i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing për një periudhe 12 mujore”.

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj.:

Hyrje

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan përfshin 6 (gjashtë) bashki me një shtrirje gjeografike të konsiderueshme dhe gjeneron rreth 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) fatura për abonentët e saj. Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” dhe Udhëzimit nr. 16 datë 03. 04. 2020 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” dhe Vendimit Nr. 239 datë 20. 03. 2020 “Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes softëare për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve softëare-ike”, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan kërkon zbatimin e një programi fiskalizimi me integrim me programin e Faturim – Arkëtimit ekzistues Flare Billing, që ka në përdorim, për të fiskalizuar faturat e abonentëve si dhe gjenerimin e faturave për shërbimet e tjera që ajo kryen.

Zbatimi

SHRUK Elbasan kërkon që të gjithë funksionalitetet e programit të fiskalizimit që ofron zgjidhja, të jenë funksionalë dhe të përdorshëm për SHRUK Elbasan. Zbatimi i këtij

programi duhet të marrë parasysh aspekte si fiskalizimi i mbi 67 000 faturave në të njëjtën kohë, përdorimin nga shumë përdorues në të njëjtën kohë. Mos kufizimi në sasinë e faturave që mund të fiskalizohen në total. Të mos ketë kufizime në numrin e përdoruesve që do ta përdorin sistemin. Çdo përparësi tjetër që operatori ekonomik mendon se ka programi që ofrohet prej tij, t'i bëhet e ditur SHRUK Elbasan sha, në lidhjen e kontratës dhe të të zbatohet në rast se AK e vlerëson të argumentuar dhe të dobishëm për përdorim. Çdo konfigurim që ofrohet në program, të kryhet sipas specifikave që ka natyra e biznesit të SHRUK Elbasan sha, dhe jo konfigurime të gabuara apo të përgjithshme, të pa dobishme për AK.

Integrimi dhe komunikimi

Sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtimit është i bazuar mbi një zgjidhje të gatshme informatike "Flare Billing". Kodi burim për kryerjen dhe zbatimin e shërbimit, ndodhet në serverin e zyrave të SHRUK Elbasan sha. Faturat e gjeneruara nga ky sistem duhet të fiskalizohen sipas udhëzimeve ligjore. Sistemi i fiskalizimit duhet të integrohet me sistemin ekzistues të Faturim – Arkëtimit, për të bërë të mundur që procesi i fiskalizimit të faturave dhe të gjitha veprimet e brendshme që duhet të kryhen në sistemin e Faturim - Arkëtimit të realizohen me sukses për të siguruar mbarëvajtjen e punës.

Programi i fiskalizimit duhet të përdorë ëeb shërbime për të komunikuar me sistemin e Faturim - Arkëtimit që përdorin protokollin standard të komunikimit siç janë SOAP, REST ose ekuivalentet e tyre. Performanca e programit të fiskalizimit nuk duhet të përkeqësojë performancën e sistemit të Faturim - Arkëtimit.

Siguria

Integrimi i zgjidhjes së fiskalizimit me atë të Faturim – Arkëtimit, duhet të kryhet në mënyrë të sigurt. Meqenëse programi i fiskalizimit kërkohet të ofrohet në Cloud, komunikimi me sistemin e faturimit duhet të plotësojë të gjithë kriteret e sigurisë dhe të shifrimit për të minimizuar risqet dhe për t'u mbrojtur nga sulme dashakeqe që mund t'i shkaktojnë dëme SHRUK Elbasan sha dhe abonentëve të shoqërisë sonë.

Në përgjithësi programi i fiskalizimit që do të zbatohet në Cloud, duhet të përmbushë të gjitha standardet e mirëfunksionimit të sigurt në Cloud siç janë aksesimi i sigurt, siguria e mjediseve të instalimit, siguria e bazës së të dhënave, mundësia e backup dhe restore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 2/2017, "Për Sigurinë Kibernetike", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 553, datë 15. 07. 2020, "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit", i ndryshuar, AK është përcaktuar si operator i infrastrukturave kritike dhe e rëndësishme të informacionit, si rrjedhim sistemi dhe infrastruktura mbështetëse e ofruar duhet të auditohen dhe të ofrohet përditësim i vazhdueshëm nga ana e sigurisë kibernetike.

Baza e të dhënave

Baza e të dhënave duhet të jetë e optimizuar që të përballojë sasinë prej të paktën 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) faturave aktuale që do të fiskalizohen në të njëjtën kohë çdo muaj, rritjen e vazhdueshme të numrit të faturave dhe veprimeve që do të kryejnë përdoruesit në sistem, gjenerimin e raporteve kurdo që t'i duhet përdoruesve të SHRUK Elbasan. Baza e të dhënave duhet të jetë e pa aksesueshme nga përdorues të tjerë, përveç specialistëve të operatorit ekonomik për nevoja të mirëmbajtjes. Të dhënat në bazën e të dhënave nuk duhet të modifikohen në ndërhyrje të drejtpërdrejt në bazën e të dhënave, duke anashkaluar ndërfaqen e programit. Gjatë zbatimit të kontratës, vetëm nëse SHRUK Elbasan do ta

kërkojë, operatori ekonomik nëpërmjet procedurave të mirë-përcaktuara, duhet të bëjë ndërhyrje në bazën e të dhënave. Operatori ekonomik në mënyrë të vazhdueshme duhet të kujdeset që baza e të dhënave të jetë e optimizuar për të dhënë performancë maksimale.

Menaxhimi i projektit

Operatori ekonomik duhet të ndjekë procese pune të mirë-planifikuara gjatë zbatimit të kontratës, sipas udhëzimeve të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve. Në mendimin tonë, metodologjia agile ose ekuivalente e saj, do të ishte më efikase e cila ndihmon në lëvizimin e projekteve në një shtrirje kohore të shkurtër dhe ofron feedback për të gjithë palët e përfshirë në projekt duke mundësuar të ndërhyhet në kohë nëse ndonjë prej proceseve nuk jep rezultatin e pritur. Menaxheri i projektit të operatorit ekonomik do të ketë në dispozicion specialistët e SHRUK Elbasan që ata të japin informacionin e duhur. Menaxheri i projektit duhet t'i bëjë të ditur planin e saktë të punës specialistëve të SHRUK Elbasan duke i qartësuar momentet kur ata do të jenë të domosdoshëm dhe çfarë kontributi pritet prej tyre që në nisjen e zbatimit të kontratës dhe gjatë të gjithë fazave të zbatimit të saj deri në dorëzim të plotë të kontratës.

Menaxhimi i shërbimit

Pasi programi të ketë nisur zbatimin dhe të ketë filluar përdorimi nga personat përkatës të SHRUK Elbasan sha, për të gjithë afatin që mbetet deri në përfundim të kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë të gjithë burimet e nevojshme për ruajtjen e nivelit të shërbimit të pandërprerë. Gjatë periudhës që ofrohet shërbimi, duhet të ketë një komunikim të rrjedhshëm mes personave përgjegjës nga ana e SHRUK Elbasan dhe menaxherit të shërbimit të operatorit ekonomik. Meqenëse shërbimi do të ofrohet në Cloud, është domosdoshmëri për SHRUK Elbasan sha, të ketë aktivitet ekonomik të pandërprerë. Mungesa e shërbimit si p.sh. mos fiskalizimi i faturave ose mos fiskalizimi në kohën e planifikuar, ndikon drejt për drejt në mungesën e të ardhurave për SHRUK Elbasan sha. Operatori Ekonomik duhet të menaxhojë mbarëvajtjen e ofrimit të shërbimit sipas praktikave ndërkombëtare të mirënjohura të ITIL ose ekuivalente.

Funksionalitetet që duhet të ketë programi:

Funksionet për Klientin:

- Programi të mundësojë marrjen dhe regjistrimin automatikisht të të gjithë klientëve nga sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtimit.
- Programi të mundësojë regjistrimin e klientëve manualisht.
- Programi të regjistrojë klientë me ID jo shqiptare.
- Programi të regjistrojë automatikisht Emër Mbiemër, Adresë kur në program vendoset NIPT-i i klientit.
- Programi të mundësojë kërkimin e një klienti:
 - me anë të **numrit të kontratës**,
 - me anë të **NIPT-it**,
 - me anë të **ID të klientit ose me Emër Mbiemër**.
- Programi të mundësojë eksportin e të gjithë klientëve në format Excel.

Funksionet për Artikullin:

- Programi të mundësojë marrjen dhe regjistrimin automatikisht të gjithë artikujve nga sistemi ekzistues i Faturim - Arkëtimit.
- Programi të mundësojë regjistrimin e artikujve manualisht.
- Programi të mundësojë vendosjen e niveleve të çmimeve.
- Programi të mundësojë editimin e artikullit si në zë ashtu dhe në çmim.
- Programi të mundësojë vendosjen e një kodi unik.
- Programi të mundësojë kërkimin e një artikulli me anë të kodit ose emërtimit.
- Programi të mundësojë eksportin e të gjithë Artikujve në format Excel.
- Programi të mundësojë importin me anë të file Excel.

Funksionet për Faturat:

- Programi të mundësojë krijimin e Faturës me para në dorë.
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës pa para në dorë (e thjeshtë).
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës Elektronike.
- Programi të mundësojë krijimin e Vetëfaturimit.
- Programi të mundësojë krijimin e Faturës Shoqëruese.
- Programi të mundësojë korrigjimin e Faturës.
- Programi të ruajë çdo version të Faturave.
- Programi të ketë mundësi të filtrojë fatura në bazë të emrit të klientit, datës, dhe totalit të faturës.
- Programi të ketë mundësi të eksportoje të gjithë faturat në file Excel.
- Programi të ketë mundësi të opsionit të pranimit të faturave që vijnë nga të tretë direkt nga ndërfaqja.

Funksionet për Arkat:

- Programi të ketë mundësi krijimin automatik të Mandatit të Arkëtimit për Faturat me para në dorë që bëhen në mënyrë manuale.
- Programi të ketë mundësi krijimin e Mandatit të Pagesës.
- Programi të ketë mundësi të gjenerojë raporte për periudha të ndryshme për gjendjen e Arkës.

Konfigurimet:

- Programi duhet të ketë rubrika për të gjitha konfigurimet e tij.
- Programi të ketë mundësi të krijimit të Roleve nga ana e vetë përdoruesit të SHRUK Elbasan.
- Programi të ofrojë mundësinë e konfigurimit të të drejtave të detajuara dhe të kombinuara, të paktën sipas mundësive të të drejtave si vijon:

Të drejta rreth klientëve	Shfaq Listën e Klientëve
	Krijo Klient të ri
	Modifiko Klient ekzistues
	Fshij Klient ekzistues
	Ruajtje me aprovim
	Administro Listën e Nivelit të Çmimeve

Të drejtat për Vendet e Ushtrimit të	Krijo Vendet ku Ushtrohet Aktiviteti
	Edito Vendet e Ushtrimit të Aktivitetit
	Lista e Vendeve e Ushtrimit të Aktivitetit

	<i>Administro Nivelin Bazë të Cmimeve</i>
--	---

<i>Të drejtat rreth Arkave</i>	<i>Shfaq Listën e Arkave</i>
	<i>Çel Arkë të re</i>
	<i>Modifiko Arke ekzistuese</i>
	<i>Fshij Arkë ekzistuese</i>
	<i>Krijo Mandat Arkëtimi</i>

<i>Të drejtat rreth Faturave</i>	<i>Shfaq Listën e Faturave të shitjes</i>
	<i>Krijo Faturë Shitje të re</i>
	<i>Modifiko Faturë Shitje ekzistuese</i>
	<i>Ruaj Faturë Shitje</i>
	<i>Shfaq Listën e Faturave Elektronike</i>
	<i>Printo e Invoice</i>
	<i>Ndrysho statusin e Invoice</i>

<i>Të drejta rreth artikujve</i>	<i>Shfaq Listën e Artikujve</i>
	<i>Krijo Artikull të ri</i>
	<i>Modifiko Artikull ekzistues</i>
	<i>Fshij Artikull ekzistues</i>
	<i>Ruajtje me aprovim</i>
	<i>Administro Nivel Çmimesh</i>

<i>Të drejtat për Përdoruesit</i>	<i>Krijo të Përdorues i ri</i>
	<i>Aktivizo Përdorues ekzistues</i>
	<i>Modifiko Përdorues ekzistues</i>
	<i>Lista e Përdoruesve</i>
	<i>Ndryshim i Fjalëkalimit të Përdoruesit</i>
	<i>Profili i Përdoruesit</i>

<i>Konfigurime</i>	<i>Cakto të drejta për çdo rol</i>
	<i>Modifiko të drejtat për çdo rol ekzistues</i>
	<i>Fshij rol ekzistues</i>
	<i>Ruaj Rol ekzistues</i>
	<i>Raportet që mund të ketë akses</i>

<i>Të drejtat rreth Raporteve</i>	<i>Shitjet sipas artikujve</i>
	<i>Libri i shitjeve</i>
	<i>Gjendja e Arkës</i>
	<i>Shitjet sipas muajve</i>
	<i>Shitjet sipas datave</i>

Funksione dhe veçori të tjera të programit:

- Të jetë i aftë të fiskalizojë të gjithë faturat e abonentëve (të paktën 67 000 fatura), çdo muaj, brenda një periudhe 2 ditore.
- Të integrohet me sistemin ekzistues të Faturim - Arkëtimit.
- Vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese.
- Të gjenerojë automatikisht Librin e Shitjeve.
- Dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin tatimor, duke përdorur certifikatën elektronike.
- Transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës fature individuale ose fature shoqëruese.
- Ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese.
- Gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH).
- Gjenerimin e kodit QR.
- Printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
- Bazat e të dhënave të jenë të pa aksesueshme jashtë këtij sistemi.
- Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “Përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
- Të ketë Log Files për çdo rast gjatë transmetimit të të dhënave nga programi drejt sistemit tatimor.
- Programi duhet të ketë auditimin e të dhënave.

Detyrat e operatorit ekonomik

- Të zbatojë programin e fiskalizimit brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
- Të integrojë brenda afatit programin e fiskalizimit me atë të Faturim – Arkëtimit.
- Të mirëmbajë programin e fiskalizimit për periudhën e përcaktuar në kontratë.
- Të suportoje stafin në zëvendësimin e certifikatës elektronike.
- Të garantojë sigurinë e të dhënave meqenëse programi është i instaluar në Cloud.
- Të garantojë back-up të të dhënave në Cloud.
- Të informojë Shoqërinë për çdo ndryshim në program.
- Të zbatojë të gjithë kërkesat e SHRUK Elbasan të përcaktuara në këtë DST.

PËRGJIGJJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre. Suporti dhe përgjigjet do të kryhen në orarin zyrtar të punës 08:00-16:30 në ditë pune nga e Hëna në të Enjte, dhe 08:00 – 14:00 ditë të Premte, përjashtuar ditët e festave zyrtare.

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategoria C (I Ulët)
Mos funksionimi i programit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i programit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i programit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i programit ndikon pjesërisht në disa përdorues

Pezullimi i punës		
<i>Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u></i>	<i>Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë te punës së tyre</u></i>	<i>Mosfunksionimi i programit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</u></i>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<i><u>Nuk ka një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit</i>	<i><u>Ka pjesërisht një mënyre alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>	<i><u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>
Koha e përgjigjes		
<input type="radio"/> 30 min. për të kthyer përgjigje	<input type="radio"/> 30 min. për të kthyer përgjigje	<input type="radio"/> 30 min. për të kthyer përgjigje
Koha e zgjidhjes		
<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas kërkesës.</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.</i>

III.3.4. Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumenteve të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar sasishtë dhe grafiku i shërbimeve objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Objekti: Shërbimet që kërkohen: “Program Fiskalizimi i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing për një periudhë 12 mujore”.

Shërbi met	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Program Fiskalizimi në Cloud i Integruar me Programin e Faturimit Flare Billing për një periudhë 12 mujore	Sipas Specifikimeve teknike	Sipas Specifikimeve teknike

- Afati i kontratës është 12 muaj duke nisur nga data e marrjes në dorëzim të zbatimit total të zgjidhjes. Afati i implementimit bashkë me integrimin me Sistemin Flare Billing, 3 (tri) ditë nga lidhja e kontratës.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, e krijuar më 1 janar 2023, ka në përbërje të saj njësitë: Elbasan, Gramsh, Peqin, Belsh, Librazhd dhe Cërrik.

Në të gjitha këto njësi bëhen pagesat e faturave të ujit të pijshëm, fatura të cilat mbështetur në udhëzimin “PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”,

Neni 2 "Fusha e veprimit", pika "1. Sipas nenit 2 të ligjit, dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura në përputhje me Ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe Ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe përcakton detyrimet për lëshimin e faturës dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit në kohë dhe detyrimeve të tjera.", janë pjesë e sistemit të fiskalizimit të tyre.

Numri i arkave të shoqërisë, që përdorin zgjidhjen me fiskalizim, janë si më poshtë:

Njësia Elbasan 1 (një)

Njësia Gramsh 1 (një)

Njësia Peqin 1 (një)

Njësia Belsh 1 (një)

Njësia Librazhd 1 (një)

Njësia Cërrik 1 (një).

Për procedurën e prokurimit për Fiskalizimin e Faturave të shoqërisë, të mbahet parasysh numri i arkave që përdorin këtë sistem, me parashikim edhe për zgjerim në rast të rritjes së numrit të abonentëve.

III.3.5. Në nenin 77, pika 4, "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se:

"4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

III.3.6. Në nenin 41 pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.3.7. Lidhur me pretendimet e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Nexia AL Consulting” SHPK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 03/1 prot, datë 08.01.2024, drejtuar ankimuesit është shprehur se: “[...] Duke ju referuar **pikës 4** të ankesës dhe kërkesës për këtë pikë të operatorit ekonomik ankimues, rikujtojmë vendimet e KPP të ndryshme në të cilat ndërmjet të tjerave thuhet që AK është përgjegjës për procedurën e prokurimit, dhe është përgjegjësia e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Thënë kjo duket totalisht e pavend kërkesa e OE ankimues që Menaxheri i Projektit të mos jetë i certifikuar në fushën e IT për vetë faktin që po flasim për një procedurë prokurimi, e cila dhe në kodin e saj ka të përshkruar që objekti i kësaj kontrate është një projekt në fushën e IT. Rrjedhimisht nuk mundet që kërkesa për Projekt Menaxher të mos jetë për punonjësën që duhet të jetë i diplomuar në një nga degët e përcaktuara si IT. Projekt menaxheri është një person kyç për mbarëvajtjen e këtij projekti pasi është personi përgjegjës që ndjek të gjithë ciklin që prej analizës dhe dizajnit të kërkesave, parametrave dhe konfigurimeve të sistemit, testimit dhe dokumentimit të projektit, gjë kjo që është e shprehur mjaft qartë dhe në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të vendosura që është pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit. Për sa i përket ngatërrimit që qëllimisht OE ankimues kërkon të bëjë ndërmjet Projekt Menaxherit dhe punonjësit i certifikuar si ITIL, theksojmë që këto janë role të ndara dhe nuk kanë asnjë lidhje me njëri-tjetrin siç dhe janë përcaktuar në procesverbalin argumentues për kriteret. Për sa i përket kërkesës për reduktimin e numrit të punonjësve dhe njëherë sjellim në vëmendje që është përgjegjësia e AK të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe në bazë të analizës së kryer nga grupi i punës pranë SHRUK Elbasan, është arritur në konkluzionin që një numër i tillë punonjësish është i nevojshëm për zbatimin me rigorozitet të kontratës. Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën lidhur me këtë kriter vendosi se pretendimi juaj nuk qëndron.

Duke ju referuar **pikave 5, 6, 7** të ankesave, sjellim në vëmendje që referuar vendimeve të KPP autoriteti kontraktor është përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësia e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Për pikat e mësipërme për të cilat operatori ekonomik ankimues ka pretendime, theksojmë që AK me anë të procesverbalit argumentues pjesë e kësaj procedure, ka argumentuar me fakte arsyen se përse kërkojnë që certifikimet të jenë në nivelet që AK ka përcaktuar. Gjithashtu në mbështetje të kërkesave specifike për nivelin e certifikimit të punonjësve të kërkuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, i është përmbajtur dhe vendimeve të KPP për procedura shërbimesh të ngjashme. Më konkretisht AK i është referuar Vendimit Nr. 1103/2023 në të cilin janë marrë

në analizë certifikimet e kërkuara. Ndërmjet të tjerave në këtë vendim në rastin e certifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur qëndrimin duke përcaktuar ndërmjet të tjerave që: “Autoriteti Kontraktor duhet të përcaktojë certifikatat bazuar në funksionin dhe nivelin e ekspertizës që duhet të zotërojnë këta punonjës, me anë të termave funksionale”

Theksojmë që nevoja e certifikimeve të tilla i nevojiten autoritetit kontraktor për të vërtetuar gjendjen faktike të operatorit ekonomik dhe nëse ai ofron garancinë për zbatimin me përpikmëri të kontratës sipas të gjitha afateve.

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën lidhur me këtë kriter vendosi se pretendimi juaj nuk qëndron. ... [...]”, duke mos pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe duke dhënë argumentet ligjore dhe teknike për këtë mospranim.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.3.9.1. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës nr. 8 “Formular i Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit, duke hequr kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesit të të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në nivel profesionist, Komisioni konstaton se kjo kërkesë është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor duke argumentuar se drejtuesi i projektit do të garantojë autoritetin kontraktor në ndjekjen ndjekjen e të gjithë ciklit të zbatimit të projektit, e cila përfshin analizim dhe dizajnimin të kërkesave, parametrave dhe konfigurimeve të sistemit, testimin dhe dokumentimin të projektit.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit dhe parashtrimet e dhëna nga ana e autoritetit kontraktor Komisioni gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesit të të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në nivel profesionist është një kërkesë e ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi referuar argumentit të entit prokurues qëllimi për të cilin është kërkuar menaxheri i projektit është e lidhur me fazën e zbatimit të kontratës dhe në këtë rast autoriteti kontraktor është përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, duke kërkuar nga ana e kontraktorit që të zbatojë

kontratën në kohë dhe me cilësi sipas specifikimeve teknike dhe grafikut të ekzekutimit të shërbimit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit, duke hequr kërkesën që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në nivel profesionist.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.9.2. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti Teknik*” të shtojcës nr. 8 “*Formular i Kriteve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, të dokumenteve të tenderit, duke modifikuar kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesit të 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT, Komisioni konstaton se kjo kërkesë është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor duke argumentuar se është bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, përkundrejt natyrës së punës objekt i këtij prokurimi, por autoriteti kontraktor nuk ka publikuar asnjë përlllogaritje të numrit të punonjësve mbështetur në afatin e ekzekutimit të shërbimit objekt-prokurimi, si dhe orëve të punës dhe pagës minimale të lejuar.

Për më tepër, Komisioni konstaton se në këtë kriter kualifikues autoriteti kontraktor nga njëra anë kërkon që ofertuesi të disponojë 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT, ndërkohë nga ana tjetër po në këtë kriter ka përcaktuar 6 (gjashtë) lloje certifikatash që duhet të kenë këta punonjës, duke patur një mospërputhje midis numrit të punonjësve të diplomuar në fushën e IT dhe numrit të punonjës që duhet të jenë të diplomuar në fushën e IT por që njëkohësisht duhet të jenë të pajisur edhe me certifikata kualifikimi, të cilat janë përcaktuar në pikat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, të këtij kriteri, duke krijuar mospërputhje midis numrit të punonjësve të diplomuar dhe numrit të punonjësve të pajisur me certifikata kualifikimi.

Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni vlereson se, kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën, si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkretë, referuar preventivit të procedurës së prokurimit, afatit të ekzekutimit të kontratës, Komisioni gjykon se kriteri për disponimin të 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT, është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar, pasi një numër i tillë punonjësish është joproporcional me objektin e prokurimit, nuk ka një analizën të kryer nga vetë autoriteti kontraktor për argumentimin e këtij numri punonjësish, si dhe ka një mospërputhje midis numrit të punonjësve të diplomuar dhe numrit të punonjësve të pajisur me certifikata kualifikimi. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 5 (pesë) punonjësish të diplomuar në fushën e IT, si dhe duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës, si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi, do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve, i cili në rastin konkret është i ekzagjeruar.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke e ulur numrin e punonjësve të diplomuar në fushën e IT në përputhje me volumin e kontratës që prokurohet.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.9.3. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti Teknik*” të shtojcës nr. 8 “*Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, të dokumenteve të tenderit, duke hequr kërkesën për nivelin “Ekspert” dhe “Profesional” përkatësisht të certifikatës në zbatimin e zgjidhjes së ofruar ose teknologjitë nga të cilat përbëhet zgjidhja, të certifikatës për sigurinë në Cloud dhe të certifikatës në implementimin e ëb shërbimeve nëpërmjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent, Komisioni konstaton se nivelet e këtyre certifikatave janë vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, me argumentin se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit, duke hequr kërkesën për nivelin e certifikatës së kërkuar në pikat “b”, “c” dhe “e” të këtij kriteri kualifikues.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “*Nexia AL Consulting*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me numër reference: REF-92432-12-28-2023, me objekt: “*Blerje program fiskalizimi*”, me fond limit 5.166.667 lekë parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Nexia AL Consulting*” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

